REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR
REKTORATI

Nr. 2101/11 Prot

Gjirokastër, më 24 . 11 . 2026

MIRATOI
REKTORI
Prof. dr. Jahë CANA

Lënda: Hapet Thirrja Publike mbi vendet e lira në Komitetet e Menaxhimit (Management Committees – MC) të COST Actions

Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) njofton se vijojnë të jenë të lira pozicione në Komitetet e Menaxhimit (MC) të COST Actions, në kuadër të programit COST (European Cooperation in Science and Technology), me synim forcimin e bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar, rritjen e pjesëmarrjes së studiuesve dhe ekspertëve shqiptarë në rrjetet evropiane dhe përfaqësimin e institucioneve shqiptare, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga AKKSHI, si më poshtë vijon:

Nr	Thirrja	Afati i fundit i dorëzimit të projekt propozimit
1	Thirrja Publike mbi vendet e lira në Komitetet e Menaxhimit (Management Committees – MC) të COST Actions	**18.05.2029**

Njoftimi i Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) për vendet e lira në Komitetet e Menaxhimit (MC) të COST Actions synon të nxisë përfshirjen e studiuesve dhe ekspertëve shqiptarë në rrjetet evropiane të bashkëpunimit shkencor, duke krijuar mundësi për shkëmbimin e njohurive dhe zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Qëllimi i thirrjes

1. Programi COST synon forcimin e bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik në nivel evropian, përmes krijimit të rrjeteve ndërkombëtare që bashkojnë studiues dhe ekspertë nga fusha të ndryshme, duke nxitur pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë, shkëmbimin e njohurive dhe krijimin e partneriteteve të reja shkencore.

2. Objektivat e thirrjes janë:

a) Forcimi i bashkëpunimit shkencor ndërkombëtar dhe zgjerimin e rrjeteve evropiane të kërkimit shkencor;
b) Rritja e pjesëmarrjes së studiuesve, kërkuesve shkencorë, pedagogëve dhe ekspertëve shqiptarë në COST Actions;
c) Nxitja e shkëmbimit të njohurive, përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet studiuesve dhe ekspertëve nga vende të ndryshme;
d) Mbështetja e përfshirjes së studiuesve shqiptarë në drejtimin, koordinimin dhe zhvillimin e aktiviteteve të rrjeteve ndërkombëtare;
e) Krijimi i mundësive të reja për bashkëpunim ndërinstitucional, zhvillim profesional dhe përfshirje në iniciativa të përbashkëta kërkimore;
f) Forcimi i përfaqësimit të institucioneve shqiptare në hapësirën evropiane të kërkimit shkencor dhe inovacionit.

Fushat Prioritare

Në kuadër të njoftimit të AKKSHI-së për vendet e lira në Komitetet e Menaxhimit (Management Committees – MC), studiuesit dhe ekspertët e interesuar mund të aplikojnë në COST Actions që lidhen me profilin e tyre akademik dhe profesional, veçanërisht në fusha si më poshtë:

- Shkencat kompjuterike, inteligjenca artificiale dhe teknologjitë digjitale;
- Shkencat mjekësore, shëndetësore dhe biomjekësore;
- Bioteknologjia dhe shkencat biologjike;
- Inxhinieria, fizika dhe shkenca e materialeve;
- Energjia, mjedisi dhe teknologjitë e qëndrueshme;
- Shkencat sociale, etika dhe privatësia digjitale;
- Shkencat humane dhe ruajtja e trashëgimisë kulturore.

Thirrjet, manualin e aplikimit dhe afatet e dorëzimit mund t'i gjeni në portalin zyrtar të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI): (https://nasri.gov.al/thirrjet/thirrje-e-hapur-ne-management-committee-mc-ne-cost-actions/)

Gjithashtu, mund të kontaktoni me Sektorin e Marrëdhenieve me Jashtë, Projekteve dhe Kërkimit Shkencor për informacion më të detajuar.

Zv/Rektore për Marrëdheniet me Jashtë dhe Kërkimit Shkencor

Prof. asoc. Merita Isaraj